

Prishtinë, 08 qershor 2011

PPS Nr: 376/2010

Gjykatës së Qarkut në Prishtinë

Në pajtim me nenet 304(1), 305 dhe 306 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Në, Isabelle Arnal, Kryeprokurore e PSRK-së, dhe Joachim Stollberg, Prokuror, parashtrojmë këtë:

AKTAKUZË

Kundër:

1)

Emri	Blerim
Mbiemri	Devolli
Emri i Babait	Ibrahim Devolli
Data e Lindjes	20 shkurt 1972
Vendi i Lindjes	Pejë
Gjinia	Mashkull
Adresa	Hasan Prishtina nr 28, Pejë, Kosovë
Kombësia	Shqiptar i Kosovës
Nënshtetësia	Kosovare
Nr. letërnjoftimit	1009459509(UNMIK ID)

Avokat mbrojtës: Z. Virtyt Ibrahimaga

2)

Emri	Shkelqim
Mbiemri	Devolli
Emri i Babait	Ibrahim Devolli
Data e Lindjes	6 gusht 1979
Vendi i Lindjes	Pejë
Gjinia	Mashkull
Adresa	Hasan Prishtina nr 28/30, Pejë, Kosovë
Kombësia	Shqiptar i Kosovës
Nënshtetësia	Kosovare
Nr. letërnjoftimit	1009008574(UNMIK ID)

Avokat mbrojtës: Z. Gani Tigani

3)

Emri	Ismet
Mbiemri	Bojku
Emri i Babait	Isat
Data e Lindjes	25 qershor 1948
Vendi i Lindjes	-
Gjinia	Mashkull
Adresa	Halil Agusholli nr 126, Pejë, Kosovë
Kombësia	Shqiptar i Kosovës
Nënshtetësia	Kosovare
Nr. letërnjoftimit	1003313910(UNMIK ID)

Avokat mbrojtës: Znj. Iliriana Osmani Serreqi

4)

Emri	Shyqyri
Mbiemri	Haxha
Emri i Babait	Rexhep
Data e Lindjes	12 nëntor 1967
Vendi i Lindjes	Svarcak i Poshtëm
Gjinia	Mashkull
Adresa	Mujë Krasniqi nr. 23/6, Ulpianë, Prishtinë dhe 3 Croën Gardens CT2 8LQ, UK
Kombësia	-
Nënshtetësia	Britaneze
Nr. i pasaportës	459920537 (Britaneze)

Avokat mbrojtës, Z. Ramë Gashi

5)

Emri	Rexhë
Mbiemri	Gjonbalaj
Emri i Babait	Halil
Data e Lindjes	1 shtator 1959
Vendi i Lindjes	Vuthaj-Mal i Zi
Gjinia	Mashkull
Adresa	Ernest Koliqi nr.2, Pejë, Kosovë
Kombësia	Shqiptar i Kosovës
Nënshtetësia	Kosovare
Nr. letërnjoftimit	2003818597

Avokat mbrojtës, Z. Tomë Gashi

Për Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI dhe Ismet BOJKU

Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 paragrafi 1 dhe 2 të KPK, e dënueshme nga gjashtë muaj deri pesë vite burg, kur vepra rezulton me dëm më të madh se 15,000 EURO; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Lidhja e kontratave të dëmshme, në kundërshtim me nenin 237 paragrafët 1 dhe 2 të KPK, e dënueshme nga një deri në dhjetë vite burg, kur kryesit e veprës shkaktojnë dëm që tejkalon 100.000 EURO; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Keqpërdorim i besimit, në kundërshtim me nenin 269 paragrafi 1 i KPK, e dënueshme me gjobë apo deri në tre vite burg; ku Blerim Devolli dhe Shkelqim Devolli kanë vepruar në ndihmë, siç lexohet me nenin 25 të KPK.

Falsifikimi i dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332 paragrafi 1 i KPK, e dënueshme me gjobë apo deri në një vite burg; në lidhje me **Veprat e posaçme të falsifikimit të dokumenteve**, në kundërshtim me nenin 333 nën-paragrafin 1 të KPK, në lidhje me nenin 332 par 3 të KPK, e dënueshme me gjobë apo deri në tre vite burg; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Krim i Organizuar, në kundërshtim me nenin 274 paragrafët 1 dhe 3 të KPK; e dënueshme me të paktën shtatë vite burg dhe shtatë deri në njëzet vite respektivisht; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Për Shyqyri HAZHA dhe Rexhë Gjonbalaj

Lidhja e kontratave të dëmshme, në kundërshtim me nenin 237 paragrafët 1 dhe 2 të KPK, e dënueshme nga një deri në dhjetë vite burg, kur kryesit e veprës shkaktojnë dëm që tejkalon 100.000 EURO; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Shpërdorimi i detyrës zyrtare, në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK, e dënueshme nga një deri në tetë vite burg, kur përfitimi material tejkalon 5.000 EURO.

Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi, në kundërshtim me nenin 236 paragrafi 1 nën-paragrafi 5 dhe paragrafi 2 i KPK, e dënueshme nga një deri në tetë vite burg, kur përfitimi material tejkalon 100.000 EURO.

Më poshtë vijojnë detajet e veprave penale.

I. Përshkrimi dhe emërtimi ligjor i veprave penale

(Sipas nenit 305 paragrafi 1 pika (3) dhe (4) e KPPK)

Pika 1

Kundër Blerim Devolli, Shkelqim Devolli dhe Ismet Bojku

Mashtrim, në kundërshtim me nenin 261 paragrafët 1 dhe 2 të KPK, në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Sepse

Ismet Bojku, ndërmjet 21 dhe 25 nëntor 2008 si përfaqësues ligjor i Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC, ka paraqitur, pas një marrëveshje të mëparshme me dhe nën mbikëqyrjen e Blerim DEVOLLIT dhe Shkelqim DEVOLLIT, një kërkesë te Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) në Prishtinë më 25 nëntor 2008 për transferimin e një licence të Operatorit të Rrjetit Mobil Virtual (MVNO) nga Dardafon LLC te Dardafon.net LLC, përkundër faktit se ka ditur strukturën e përgjithshme të aksionarëve brenda Dardafon LLC. Ai kishte deklaruar rrejtshëm para vendim marrësve në ATR se transferimi i licencës bazohej mbi njohuritë dhe marrëveshjen e shumicës së aksionarëve të Dardafon LLC, Unitel Ēorld dhe pronarit të saj, Z. Adrian Shatku. Z. Shatku as nuk ka ditur se një transferim i tillë i licencës së MVNO do të ndodhte, e as që ishte pajtuar që licencë të transferohej tek Dardafon.net LLC. Për shkak të kërkesës së rrejshme të Ismet Bojkut, ART transferoi licencën nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC, që rezultoi që Dardafon LLC humbi licencën për të cilën kishte investuar 50.000,00 Euro. Kështu që, vlera financiare tejkalon 15.000,00 Euro.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 2

Kundër Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI, Ismet BOJKU

Lidhja e kontratës së dëmshme, në kundërshtim me nenin 237 paragrafi 1 dhe 2 të KPK; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryejte)

Sepse

Edhe pse kanë ditur në bazë të arsyeve të përmendura nën pikën 1, që me transferimin në fjalë Dardafon LLC do të humbte licencën e MVNO, Ismet Bojku, në bazë të urdhrave dhe mbikëqytjen e Blerim Devollit dhe Shkelqim Devollit kanë përshtuar, nënshkruar dhe parashtruar kërkesën në ART. Duke pasur parasysh se Devolli Company ishte vetëm aksionar i vogël në Dardafon LLC, kurse Shkelqim Devolli ishte pronar i 90% të Dardafon.net LLC, Blerim Devolli dhe Shkelqim Devolli morën kontrollin faktik mbli licencës e MVNO duke transferuar në Dardafon.net LLC, duke rezultuar me humbje të madhe për Dardafon LLC.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 3

Kundër Ismet BOJKU, Blerim DEVOLLI dhe Shkelqim DEVOLLI

Keqpërdorim i Besimit në kundërshtim me nenin 269 paragrafi 1 i KPK; në lidhje me nenin 25 (ndihmë)

Sepse

Në pozitën e tij si përfaqësues ligjor i Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC në vitin 2008, Ismet BOJKU paraqiti kërkesën e përshkruar më lart për Dardafon.net LLC në ART në Prishtinë më 25 nëntor 2008, për të transferuar licencën e MVNO nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC. Duke vepruar kështu, ai ka shkelur mirëbesimin ndaj Dardafon LLC, që ka rezultuar që Dardafon LLC të pësojë humbje të mëdha financiare të një aseti. Blerim DEVOLLI dhe Shkelqim DEVOLLI urdhëruan Ismet BOJKUN të paraqesë kërkesën për transferim.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 4

Kundër Ismet BOJKU, Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI

Falsifikimi i dokumenteve, në kundërshtim me nenin 332 paragrafi 1 i KPK, në lidhje me Veprat e posaçme të falsifikimit të dokumenteve, në kundërshtim me nenin 333 nën-paragrafin 1 të KPK, në lidhje me nenin 332 par 3 të KPK, e dënueshme me gjobë apo deri në tre vite burg; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Sepse

Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI dhe Ismet BOJKU, në vend dhe kohë të papërcaktuar gjatë vitit 2008 ose 2009, ndikuan në përpilimin e tekstit të marrëveshjes së MVNO datë 16 janar 2009 ndërmjet PTK dhe Dardafon.net LLC, apo kanë përpiluar vetë marrëveshjen, përkundër faktit se e kanë ditur se në dokumentet janë përfshirë fakte të pavërteta. Marrëveshja thekson se Dardafon.net LLC kanë bërë një Projekt Marrëveshje "HoA" në gusht 2008 me PTK-në, kurse në realitet, kjo "HoA" ishte bërë ndërmjet Dardafon LLC dhe PTK. Dardafon.net LLC nuk ka ekzistuar në gusht të vitit 2008. Marrëveshjan finale e MVNO-së ishte shkruar si specifikacion dhe ishte zhvilluar më tej si "Projekt Marrëveshje". "Projekt Marrëveshja" (HoA) ishte pjesë integrale e marrëveshjes së MVNO-së, e shënuar si aneksi 7.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 5

Kundër Ismet BOJKU, Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI

Krim i Organizuar, në kundërshtim me nenin 274 paragrafët 1 dhe 3 të KPK; në lidhje me nenin 23 të KPK (bashkë kryerje)

Sepse

Në nëntor 2008, kompania Dardafon.net LLC ishte themeluar dhe ishte 90% pronë e Shkelqim DEVOLLI, kurse Blerim DEVOLLI vepronte se drejtor ekzekutiv, kurse Ismet BOJKU ishte përfaqësues ligjor.

Më 21 nëntor 2008, kompania Dardafon.net LLC ishte regjistruar në Kosovë dhe ende ekziston deri në momentin e parashtrimit të kësaj aktakuze. Ismet BOJKU, Shkelqim DEVOLLI dhe Blerim DEVOLLI kishin rolet e tyre të qarta brenda Dardafon.net LLC. Ismet BOJKU ishte përfaqësues ligjor dhe përfaqësoi kompaninë dhe aplikoi pranë ART-së për transferimin e licencës nga Dardafon LLC në Dardafon.net LLC. Blerim DEVOLLI përfaqësoi Dardafon.net LLC në negociata më palët e treta. Aprovimi i ART-së për transferimin e licencës i ishte dërguar atij. Blerim DEVOLLI u takua me Z. Ramaxhiku nga PTK-jë për tu informuar në lidhje me statusin e negociatave me PTK-në në vjeshtë të vitit 2008. Blerim DEVOLLI negocioi marrëveshjen për Dardafon.net LLC me Adrian Shatku në vitin 2009. Z. Shkelqim DEVOLLI ishte pronar i 90% të Dardafon.net LLC, duke marrë përsipër përgjegjësinë ligjore për kompaninë në fjalë kurse nga prapavija e kontrollonte atë. Duke përdorur Dardafon.net LLC, Ismet BOJKU, Blerim DEVOLLI dhe Shkelqim DEVOLLI kanë kryer krime të ndryshme të natyrës shumë serioze, përfshirë mashtrim, që dënohet deri më 5 vite burg (pika 1 e kësaj Aktakuze), dhe Lidhja e marrëveshjes së dëmshme, që dënohet deri në dhjetë vite (pika 2 e kësaj Aktakuze). Dardafon.net LLC ishte themeluar në mënyrë specifike me qëllim që Ismet BOJKU, Blerim DEVOLLI dhe Shkelqim DEVOLLI të kryejnë veprat e cekura në Aktakuzë, dhe rrjedhimisht të marrin përfitime financiare.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 6

Kundër Ismet BOJKU, Blerim DEVOLLI, Shkelqim DEVOLLI

Lidhja e kontratës së dëmshme, në kundërshtim me nenin 237 paragrafët 1 dhe 2 të KPK

Sepse

Më 20 tetor 2008 në Prishtinë në takimin e Bordit të Drejtorëve të PTK-së, Rexhë Gjonbalaj si kryesues i Bordit të PTK-së, qëllimisht ka votuar në favor – dhe pa rezerva – që PTK-ja të lidh marrëveshje MVNO me Dardafon LLC. Aprovimi parashihte që Dardafon LLC kishte të drejtë si MVNO të përdorte resurset e telekomunikacionit të PTK-së kurse si kthim është i obliguar të paguajë një ndarje të fitimit me PTK-në në vlerë prej 22%. Rexhë Gjonbalaj e ka ditur se marrëveshje përfshinte një ndarje të papranueshme të fitimit prej 22% dhe një mungesë e sigurisë së domosdoshme për PTK-në, dhe ishte bazuar në propozimin për ndarjen e fitimit, të cilin më parë Bordi e kishte refuzuar. Z. Gjonbalaj ishte forca kryesore në Bordin e PTK-së që marrëveshja e MVNO-së të aprohet me këtë ndarje të papranueshme të fitimit dhe përmbytjen e pasigurt.

Shyqyri HAXHA si Kryeshef Ekzekutiv i PTK-së nga dhjetori 2008 ka nënshkruar marrëveshjen finale të MVNO-së, datë 16 janar 2009, ndërmjet PTK-së dhe Dardafon.net LLC, duke ditur se kjo marrëveshje do ti shkaktonte humbje PTK-së në vlerë të pallogaritshme që do të tejkalonte 100.000,00 EURO. Shyqyri HAXHA ka nënshkruar secilën faqe të marrëveshjes së MVNO-së ndërmjet Dardafon.net LLC dhe PTK, përfshirë Aneksion 7, që përmban "HoA" ndërmjet Dardafon LLC dhe PTK, duke shkelur kështu obligimin para-kontraktual me Dardafon LLC. Më tej, Shyqyri HAXHA, përkundër faktit se ka pasur njohuri mbi pafavorshmërinë dhe pasigurinë e marrëveshjes, ai ka nënshkruar MVNO-në me një ndarje të fitimit prej 27% në dëm të PTK-së, duke i shkaktuar kështu dëm të madh PTK-së.

Ai veproi kështu përkundër rekomandimeve të dhëna nga një i ashtuquajtur Task Force 2, i themeluar nga Bordi i Drejtorëve për të gjetur një ndarje fitimprurëse për PTK-në. Task Force 2 arriti në rezultatin se ndarja e fitimit do të duhet të ishte së paku 73% për PTK-në me qëllim të shmangies së humbjeve.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 7

Kundër Shyqyri HAXHA

Keqpërdorimi i pozitës zyrtare, në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1, 2 dhe 3 të KPK.

Sepse

Shyqyri HAXHA ka nënshkruar marrëveshjen e lartpërmendur të MVNO-së përkundër faktit se ka qenë ekonomikisht e pafavorshme për PTK-në dhe shkelte obligimet para kontraktuale kundrejt Dardafon LLC. Ai lidhi këtë marrëveshje duke shkelur obligimet e tij si Kryeshef në kushte të atilla që ai kishte marrë presione nga jashtë për të nënshkruar marrëveshjen e MVNO-së e jo duke nënshkruar marrëveshjen mbi baza të obligimeve të tij nga PTK-së. Pasi që Z. Haxha ka nënshkruar marrëveshjen me Dardafon.net LLC dhe jo me Dardafon LLC, kjo ka rezultuar me dëmtimin e Dardafon LLC duke tejkaluar 2.500,00 Euro dhe i ka siguruar Dardafon.net LLC një përfitim material që tejkalon 5.000,00 Euro.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 8

Kundër Shyqyri HAXHA

Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, në kundërshtim me nenin 236 paragrafi 1, nën-paragrafi 5 dhe paragrafi 2 i KPK.

Sepse

Shyqyri HAXHA si Kryeshef ekzekutiv i PTK-së, më 16 janar 2009 në Kosovë, ka nënshkruar marrëveshjen e lartpërmendur të MVNO me qëllim që ti sigurojë Dardafon.net LLC një përfitim ekonomik për të shërbyer si MVNO për PTK-në gjithandej Kosovës, që është një e drejtë që tejkalon përfitimin material prej 100.000,00 Euro.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë me veprën e përshkruar në pikën 6:

Kundër Rexhë GJONBALAJ

Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, në kundërshtim me nenin 236 paragrafi 1, nën-paragrafi 5 i KPK.

Sepse

Rexhë GJONBALAJ si Kryesues i Bordit të Drejtorëve të PTK-së ka bërë presion në Bordin e Drejtorëve në tetor 2008 në Prishtinë që të aprovohet kontrata MVNO ndërmjet Dardafon LLC dhe PTK, në favor të Dardafon LLC mbi bazë se ishte aprovuar vetëm nga një anëtar i Task Forcës 1. Në disa raste gjatë takimit të Bordit në tetor 2008, dhe përkundër faktit se e ka ditur se shumica e anëtarëve të bordit nuk e kanë përfunduar mendimin e Task Forcës 1 dhe kanë kërkuar analiza të mëtejme të ekspertëve nga Task Forca 2, ai në mënyrë të përsëritur ka kërkuar votimin mbi propozimin e Task Forcë 1 para se Task Force 2 i kishte paraqitur konstatimet e saj, dhe ka tentuar të listohet nga anëtarët e Bordit rezultatin e gjetjeve të Task Force 2. Rexhë GJONBALAJ e ka ditur se rezultati i Task Force 1 nuk ishte përfundimtar, jo i leverdishëm dhe jo i bazuar në një mendim unanim.

Për më tepër, nga ai dhe veprimi i njëjtë:

Pika 10

Kundër Rexhë GJONBALAJ

Shpërdorimi i pozitës zyrtare, në kundërshtim me nenin 339 paragrafët 1 dhe 2 të KPK.

Sepse

Derisa Rexhë GJONBALAJ ka bërë presion në Bordin e Drejtorëve në tetor 2008 në Prishtinë që të aprovohet kontrata MVNO e përmendur më lart, ai ka tejkaluar kompetencat e tij si Kryetar i Bordit të Drejtorëve kur ka bërë një ndikim të pabazë në anëtarët e Bordit, duke ditur se marrëveshja e MVNO ishte a pafavorshme dhe duke e ditur se shumica e anëtarëve të Bordit para 20 tetorit 2008 nuk kishin përfunduar mendimin e Task Forcës 1. Me aprovimin e marrëveshjes së MVNO në bazë të konstatimeve të Task Forcës 1, Rexhë GJONBALAJ i ka siguruar Dardafon LLC

erfitim material, gjë që nuk pasqyrohet në një mendim të pandikuar të shumicës së anëtarëve të Bordit. Përkundër faktit se vetëm një anëtar i Bordit i ka dhënë mbështetje marrëveshjes MVNO edhe pas një shqyrtimi të nivelit të përqindjes në ndarjen e fitimit, ky kufizim u injorua nga Z. GJONBALAJ dhe nuk gjeti reflektim në vendimin e Bordit.

II. Shpjegimi i bazave për këtë Aktakuzë

(Sipas nenit 305 paragrafi 1 pika (5) e KPPK)

A. SFONDI I FAKTEVE

1. Më 9 janar 2007, Dardafon LLC u regjistrua zyrtarisht në Kosovë, me numër biznesi 70401181. Deri në shtator 2009, Dardafon LLC ishte pronë e

- UNITEL World Inc. (48%) – aksionar kryesor Adrian Shatku

UNITEL World Inc ishte kompani subsidiare e UNIFI Holdings, një nga bartësit kryesor në botë të trafikut ndërkombëtar të zërit.

- VIA One Technologies Inc (10%) (SEBA); dhe

- Devolli Group Company (42%)

Devolli Group Company ishte pronë e Shkelqim Devolli (50%) dhe Blerim Devolli (50%); Ismet Bojku ishte anëtar i bordit të drejtuesve dhe përfaqësues ligjor.

2. Më 21 nëntor 2008, Dardafon.net LLC u regjistrua zyrtarisht në Kosovë me numër biznesi 70540878. Dardafon.net LLC ishte pronë e Shkelqim Devolli (90%) dhe K-Com Group Ltd (10%). Ismet Bojku shërbeante si përfaqësues ligjor dhe drejtor ekzekutiv "me autorizime të plota" në Dardafon.net LLC që nga 12 nëntori 2008.

3. Dardafon LLC dhe Dardafon.net LLC janë dy kompani krejtësisht të ndryshme.

Ngjarjet që quan në nënshkrimin e Kokës së Marrëveshjes ndërmjet PTK dhe Dardafon LLC

4. Pasi që Dardafon LLC ishte regjistruar zyrtarisht më 9 janar 2007, kompania përmes VIA One shfaqti interes për mundësi për MVNO me PTK/Vala përmes një letre të datës 27 maj 2007. PTK publikoi një "Shprehje të Interesit" për të siguruar shërbime MVNO më 3 tetor 2007. Me qëllim që të jenë në gjendje të nënshkruajnë një marrëveshje me PTK-në, ishte e domosdoshme që Dardafon LLC të siguronte një licencë telekomunikacioni MVNO nga Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) i Kosovës. Më 17 dhjetor 2007, Ismet Bojku në emrin e Dardafon LLC informoi ART përkritazi me "interesin e tyre zyrtar" për të marrë një licencë nga ART. Më pas, Dardafon LLC apliloi në ART për të marrë një licencë MVNO. Dardafon LLC siguroi dokumentet e domosdoshme për ART në pajtim me kornizën rregullative.

5. Më 27 mars 2008, Adrian Shatku në emër të Dardafon LLC lidhi një Marrëveshje Konsultimi dhe Këshillimi me kompaninë Evere Partership për çështje që kanë të bëjnë me licencat e MVNO-së në Kosovë. Marrëveshja nënshkruhet nga Adrian Shatku. Paragrafi 2 i kësaj marrëveshjeje thekson se në rast se Dardafon LLC i jepet licenca e MVNO-së, do ti paguajë kompanisë Evere Partership 500.000 EURO menjëherë pas pranimit të licencës, 500.000 EURO pas përfundimit të negociatave me PTK-në dhe 20 kiste mujore prej 150.000 EURO pas përfundimit të negociimit ndërmjet Dardafon LLC dhe PTK-së.

6. Më 29 maj 2008 – që i bie gati 8 muaj pas aplikimit për sigurimin e licencës për MVNO nga Dardafon LLC – Komisioni për Licencim, Autorizim dhe Monitorim (KLAM) i ART-së konstatoi se të gjitha kushtet ligjore ishin plotësuar që Dardafon LLC ti jepet licenca.

7. Më 2 qershor 2008, ART informoi Dardafon LLC për kualifikimin e tyre për të siguruar një licencë MVNO dhe kërkoi nga Dardafon LLC të depozitonte 50.000,00 EURO në llogarinë e ART-së, gjë të cilën Dardafon LLC e bëri. Më 12 qershor 2008, ART miratoi licencën e MVNO-së për Dardafon LLC për një periudhë 15 vjeçare.

